



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA TROPOJE

Nr. 5224 Prot

B.Curri me 16/11/2023

PROJEKT-VENDIM

Nr. datë . 2023

**“PËR
MIRATIMIN E PAGAVE PËR PERSONAT E ZGJEDHUR,
EMËRUAR, NËPUNËSVE CIVIL, PUNONJËSVE
ADMINISTRATIVË, PUNTORËVE TË SHËRBIMEVE, NJËSIVE
SOCIAL KULTURORE DHË TË NJËSIVE ADMINISTRATIVE NË
VARËSI**

Fëshilli Bashkia! Tropojë me propozim të Kryetarit të Bashkisë Tropojë në mbledhjen e tij të datës _____.2023 bazuar në ligjin nr. 139/2015 dt. 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore" neni 54, germa ç ,Ligjin nr.152/2013"Per nëpunësin civil" i ndryshuar , Ligjin Nr 7951 date 12.07.1995 "Kodi i Punës I Republikës së Shqipërisë" i ndryshuar, Ligji Nr.44/2015 datë 30.04.2015 "Kodi I Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë" , Ligjit Nr.35/2023 "Për kompetencat për caktimin e pagave ,trajtimeve të tjera financiare dhe perfitimeve të punësuarve në institucionet e administratës publike si dhe të pages minimale në shkallë vendi" ,VKM nr. 326 datë 31.05.2023 "Për pagat e punonjësve mbështetës dhe punonjësve të tjerë të specialiteteve të ndryshme në disa institucioneve të administratës publike; VKM nr. 328 dt 31.05.2023 "Për klasifikimin e funksioneve, grupimin e njësive të vetëqeverisjes vendore, për efekt page, dhe caktimin e kufijve të pagave të funksionarëve të zgjedhur e të emëruar, të nëpunësve civile e të punonjësve administrative të njësive të vetëqeverisjes vendore"; VKM nr. 325 dt. 31.05.2023 "Për miratimin e strukturës së pagave, niveleve të pagave dhe shtesave të tjera mbi pagë " zëvendësministrit, funksionareve të kabineve, prefektit, nënprefektit, nëpunësve civile dhe nëpunësve në disa institucione të administratës publike"

V E N D O S I:

Të miratojë pagat për personat e zgjedhur, emëruar, nëpunësve civil , punonjësve administrative, puntorëve të shërbimeve, njësive social kulturore dhe të njësive administrative në varësi si më poshtë:

A-PËR FUNKSIONARËT E ZGJEDHUR DHË TË EMËRUAR:

-Kryetari i Bashkisë	Lidhja nr.1 Gërma "d"	125 000 leke pagë	bruto
-Zv/Kryetarët e Bashkisë	Lidhja nr 1. Gërma "d"	105 000 " "	" "

-Sekretari i Përgjithshem	Lidhja nr.6 kl.I kat.I-b	80 000	“	“	pozic.
-Sekretari i Këshillit Bashkiak	kategoria II-B L.nr.6	70 000	“	pagë	pozic.
-Drejtori i Kabinetit të Kryetarit	kategoria II-B L.nr.6	70 000	“	“	“
-Keshilltar i Kryetarit	kategoria III-a/1 lidhja nr.6	56 000	“	pagë	pozic.
-Zëdhënësi i Bashkisë	kategoria III-a/1 lidhja nr.6	56 000	“	pagë	pozic.
-Sekretar i Kryetarit	kategoria IV-b lidhja nr.6	34 500	“	pagë	pozic
-Drejtor Drejtorie	kategoria II-b lidhja nr.6	70 000	“	“	“
-Përgjegjës Sektori	kategoria III-a/1 lidhja nr.6	56 000	“	“	“
-Përgjegjës Sektori	kategoria III-b lidhja nr.6	49 500	“	“	“
-Specialist (Inspektor)	në Administratën e Bashkisë	Kategoria IV-a	41 600	“	“
-Specialist (Inspektor)	në Njesitë Administrative	Kategori IV-b	34 500	“	“

Shtesa për vjetërsi në punë , që jepet në masën 2% për qind , pas çdo viti punë , deri në 25 vjet , llogaritet mbi shtesen e nivelit të kualifikimit .

B-PAGAT PËR ADMINISTRATORËT E NJËSIVE ADMINISTRATIVE

- Administrator Njësive Administrative mbi 5000 banore lidhja nr.9 pika 3 95 000 leke pagë bruto .
- Administrator Njësive Administrative nën 5000 banore lidhja nr.9 pika 4 80 000 leke pagë bruto

C-PAGAT PER PERSONELIN E GJENDJES CIVILE NE NJESI ADMINISTRATIVE DHE BASHKI

Sipas VKM nr. 325 dt. 31.05.2023 "Për miratimin e strukturës së pagave, niveleve të pagave dhe shtesave të tjera mbi pagë të zëvendësministrit, funksionareve të kabineteve, prefektit, nënprefektit, nëpunësve civile dhe nëpunësve në disa institucione të administratës publike

- Përgjegjës i zyrës së gjendje civile në bashki kategoria IV-2 paga pozicionit 70 000 leke lidhja nr.12.
- Përgjegjës I zyrës së gjendjes civile në Njësit Administrative kategoria IV-3 paga pozicionit 60 000 leke lidhja nr.12.
- Specialist i zyrës së gjendjes civile në bashki kategoria IV-3 paga pozicionit 60 000 leke lidhja nr.12
- Specialist i zyrës së gjendjes civile në Njësin Administrative kategoria IV-4 paga e pozicionit 50 000 leke lidhja nr.12

SHTESA PËR VJETËRSI NË PUNË JEPET NË MASËN:

- 0.6% pas çdo viti pune për 10 vitet e para (1–10 vite) dhe llogaritet mbi pagën e pozicionit;
- 0.8% pas çdo viti pune për 10 vitet e dyta (11–20 vite) dhe llogaritet mbi pagën e pozicionit;
- 1% pas çdo viti pune për 10 vitet e treta (21–30 vite) dhe llogaritet mbi pagën e pozicionit

Ç- PËR SEKTORIN E POLICIS BASHKIAKE

Përgjegjës I Policis Bashkiake	paga	51 000 leke	pagë	bruto
Punonjës I Policise Bashkiake	paga	49 200 leke	pagë	bruto

D-PËR PUNONJËSIT ADMINISTRATIVË TË BASHKISË , TË NJËSIVE NË VARËSI , PUNONJËSVE TË TJERË NË DREJTORINE E TURIZMIT SHËRBIMEVE PUBLIKE DHE TRANSPORTIT , TË SHËRBIMEVE

MBËSHTETËSE TË ARSIMIT PARAUNIVERSITAR , PAGAT DO TË JENË SI MË POSHTË:

Nr	Emërtimi	Klasa	Shtesa për vjetërsi në %	Paga Bazë
1	Pastrues,sanitar,centralist,korrier,roje objekti pa arme,puntor,shërbimi,gjelbërimi,dekorir,rrobalarës,mirëmbajtje varreza,puntor pastrimi qyteti,puntor mirëmbajtje rruge , Lulishtar	I	1%	40 000
2	Puntor ngarkim shkarkimi,kaldaist, arkëtar, ,edukatore çerdheje, ndihmes kuzhinier në kopshte , elektriciist	II	1%	41 000
3	Roje me arme, shofer autoveture,shofer automjeti deri 25 tone,	III	1%	41 800
4	Magaziniier ,operator	IV	1%	42 500
5	Operator . Përgjegjësi qendres kulture , guzhinier ne kopshte, muzeut, përgjegjës i klubit të sportit , përgjegjës çerdhje , teknik i mesëm i specialiteteve të ndryshme , Brigadier i Brigades së Shërbimeve , Brigadier i Brigades së Pastrimit , Operator audioviziv, fotoreporter ,telekronist , zëtorist, ekspeditor , fotograf , dispeçier, montazhier,kuzhinier	V	1%	42 800
6	Minator ,nërlidhës,piktor,dizenjator,punonjës sekretarie	VI	1%	43 200
7	Shofer i automjeteve me kapacitet mbi 2.5 ton Sekretar i shkolles 9 vjecare,instruktur , kujdestar në qendrat e kujdesit social , punonjës bibliotekë, metodist muzike, fonist	VII	1%	43 600
8	Punonjës i arkivit . Regjizor/koreograf, sekretar shkolle në shkollat e mesme	VIII	1%	44 100
9	Shofer me automjete special, kryesondist.	IX	1%	44 800
10	Përgj.i ofiçines transportit, punonjës i gjendjes civile në njesitë administrative , Përg.Groupi për mirëmbajtjen e rrugëve	X	1%	45 300
11	Punonjes i gjendjes civile ne bashki	XI	1%	45 700
12	Nd/manovrator i makinerive të rënda nd/fadromist, skavatorist	XII	1%	46 000
13	Monovrator i makinerive të rënda	XIII	1%	46 700

- Punonjësit administrativë , përveç pagës bazë , përfitojnë shtesë për vjetërsi në punë . Kjo shtesë aplikohet në masën 1 për qind mbi pagën bazë të përcaktuar për çdo klasë . Për llogaritjen e kësaj shtese merret për bazë vjetërsia e përgjithshme në punë , por jo më shumë se 25 vjet .

DH-Shpërblimi i këshilltarëve të këshillit bashkiak do të jetë në përputhje me nenin 51 të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” ne masën 10 % të pagës së Kryetarit të Bashkisë.

E-Shpërblimi për Kryetarët e Fshatrave të jetë në masën 10 % të pagës së Administratorit të njësisë Administrative në të cilën ndodhet fshati përkatës.

Ë- Shpërblimi për Ndërlidhësat Komunitar të jetë në masën 10 % të pagës së Kryetarit të Bashkisë.

G- Sipas VKM nr. 328 dt 31.05.2023 "Për klasifikimin e funksioneve, grupimin e njësive të vetëqeverisjes vendore, për efekt page, dhe caktimin e kufijve të pagave të funksionarëve të zgjedhur e të emëruar, të nëpunësve civile e të punonjësve administrative të njësive të vetëqeverisjes vendore", Specialistët e TIK-ut të paguhet me 5.000 (pesë) lekë shtesë në muaj .

H-Për punonjësit e shërbimeve Mbështetëse, shtesa për punë të vështira në dëm të shëndetit të punonjësve të jepet në zbatim të pikës 8,9 germa a,b,c të vkm nr. 717 date 23.06.2009 I ndryshuar , pasi të përcaktohet shkalla e vështirësisë nga Drejtoria e Shëndetit Publik Tropojë dhe pasi të merret miratimi në Ministrinë e Shëndetësisë .

I-Punëtorët e Bordit të Kullimit dhe të Shfrytëzimit Pyjor (vrojtues pylli) njësohen me punëtorët e shërbimeve publike kl.I . Këta punëtorë marrin 1% shtesë mbi pagë por jo më shumë se 25 vite.

J-Për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi ngarkohen , Kryetari I Bashkisë , Drejtoria Ekonomike , Sektori I Burimeve Njerezore dhe Sektori Juridik I Prokurimeve Publike dhe Apeliimit Tatimor .

K-. Efektet financiare që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi , fillojnë nga data 01 prill 2023 dhe do të përballohen nga Buxheti i Bashkisë Tropojë për vitin 2024.

Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6, të nenit 55, të ligjit nr. 139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore", të ndryshuar .

